

## Vendim nr. 154 datë 04.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 04.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 22 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** AGIM LEKA, LAVDIE LEKA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-778, datë 11.05.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 30, 31, 32, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të saj; neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Shtetasit Agim Leka dhe Lavdie Leka (*kërkuesit*), në datën 04.04.2016 kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (*Prokuroria*

e Vlorës). Në kallëzimin e tyre, kërkuesit kanë parashtruar se janë palë në një gjykim civil, ku pala e paditur A.D. ka paraqitur në gjykim disa “prokura të posaçme”, të lëshuara nga shtetasit O.L., E.L. dhe S.L. për llogari të M.L., dokumente të cilët janë të falsifikuar. Për këtë kallëzim, pasi ka kryer disa veprime verifikuese, Prokuroria e Vlorës, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. 906 të vitit 2016, ndërsa ka konkluduar se fakti penal i kallëzuar nuk përbën veprë penale. Ndaj këtij vendimi kërkuesit kanë ushtruar ankim në gjykatë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 340, datë 07.11.2016, ka vendosur mospranimin e ankimit penal të kërkuesve ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal. Sipas gjykatës, vendimmarrja e organit të akuzës ka ardhur si rezultat i kryerjes në mënyrë shteruese të të gjitha veprimeve hetimore, në funksion të individualizimit të faktit penal dhe autorit të tij, të cilat duke i ballafaquar me pretendimet objekt ankimi të ngritura nga ankuesit, rezultojnë të ezauruara, qoftë nga pikëpamja sasiore, qoftë nga pikëpamja cilësore dhe me të drejtë është arritur në përfundimin se, fakti i kallëzuar nuk përmban elemente të ndonjë figure veprë penale. Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë paraqitur ankim.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 56, datë 16.03.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke i gjetur të drejta konkluzionet e saj rreth plotësisë së veprimeve të kryera nga organi i akuzës dhe panevojshmërisë së marrjes si provë të një ekspertimi grafik për sa kohë vetë pjesëmarrësit në akt nuk i kontestojnë ato. Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë ushtruar rekurs.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-778, datë 11.05.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 11.06.2024 (sipas shërbimit postar), kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 13.06.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesve

6. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me arsyetim tepër formal, duke mos e kthyer çështjen për rigjykim me detyrat përkatëse, nuk ka bërë të mundur zbulimin e një

vepre penale të mundshme si ajo e falsifikimit, çka ka ndikuar edhe në procesin civil të kërkesve.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkesve

7. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Kolegji çmos se kërkuetit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Kolegji konstaton se në ankimin kushtetues individual kërkuetit kanë kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor të ankimit ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e bërë nga ata. Në këtë situatë, rezulton se kërkuetit nuk kanë më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë përmbushet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është

paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesit, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 11.05.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 11.06.2024, sipas shërbimit postar. Për qëllime të këtij shqyrtimi i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë, e cila me informacionin e datës 27.06.2024, ka sqaruar se vendimi i saj objekt kundërshtimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 17.07.2023, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Gjithashtu, sipas akteve të vëna në dispozicion me ankimin kushtetues individual, nuk rezulton që kërkuesit të kenë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit (*e-mail*).

12. Ndërkohë nga ana e kërkuesve, në ankimin kushtetues individual pretendohet se ata janë njohur me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë në datën 13.03.2024, pas kërkesës së tyre drejtuar asaj gjykate dhe se e kanë depozituar ankimin kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor. Kolegji vlerëson se data në të cilën kërkuesit kanë marrë vendimin e Gjykatës së Lartë pas kërkesës së tyre nuk është argument i mjaftueshëm kushtetues në lidhje me datën efektive të marrjes dijeni të tij, sepse një kërkesë e tillë për të tërhequr kopje të vendimit gjyqësor mund të bëhet në çdo moment nga palët ndërgjyqëse.

13. Në këndvështrim të sa më sipër, duke pasur parasysh standardet e vendosur nga Gjykata si dhe duke qenë se kërkuesit nuk kanë paraqitur ndonjë argument ose provë në lidhje me pamundësinë e tyre reale për të ndjekur fatin e rekursit të ushtruar nga ata, Kolegji vlerëson se si datë e marrjes dijeni të vendimit të Gjykatës së Lartë do të konsiderohet data kur ai është bërë i disponueshëm për palët, pra 17.07.2023. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione temporis* për kërkesën e tyre, pasi ankimi kushtetues individual, është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

14. Në kushtet kur një nga kriteret paraprake nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.